

Ligji Nr. 02/L-59

PËR FILARMONINË, OPERËN DHE BALETIN E KOSOVËS

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (e) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

me qëllim të krijimit të infrastrukturës dhe rregullativës ligjore përkitazi me veprimtarinë, aktivitetet dhe funksionimin institucional të Filarmonisë, Operës dhe Baletit në Kosovë,

Miraton:

LIGJIN PËR FILARMONINË, OPERËN DHE BALETIN E KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi i ligjit

1.1. Me këtë ligj rregullohen themelimi, vazhdimësia, puna, organizimi, veprimtaria dhe funksionimi i institucioneve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit në Kosovë.

1.2. Me këtë ligj në veçanti rregullohen:

- Themelimi, vazhdimi i punës dhe i veprimtarisë së filarmonisë, operës dhe baletit;

- Rregullimi dhe organizimi i tyre i brendshëm;
- Udhëheqja dhe drejtimi i tyre;
- Statusi, të drejtat dhe detyrat e punonjësve të filarmonisë, operës dhe baletit;
- Çështjet tjera të rëndësishme për veprimtarinë e filarmonisë, operës dhe baletit.

Neni 2

Përkufizimet

2.1. Filarmonia është emërtim për orkestrën e madhe simfonike, të përbërë prej 80-100 instrumentistëve, të ndarë në katër seksione kryesore: harkorët, frymorët e drunjtë, frymorët e tunxhit dhe perkusionet. Repertori i këtij formacioni orkestral është i larmishëm dhe përpos ekzekutimit të veprave të formacionit më të vogël se ai standard ekzekutohen edhe vepra për formacion edhe më të madh si për solistë e orkestër (koncerte) dhe vepra vokalo instrumentale, me ç'rast këtij formacioni i bashkëngjiten edhe kori dhe solistët vokal (kantata, oratoriumi etj.). Bashkëveprimi i këtij formacioni mundësohet me anë të dirigjentit i cili ka detyrën e koordinimit të tërësishëm të të gjithë instrumentistëve dhe solistëve.

2.2. Baleti është shfaqje skeniko - muzikore e trupës vallëzuese. Kjo shfaqje përcillet me skenografi dhe me kostume adekuate. Baza dramaturgjike është libretoja në bazë të së cilës edhe kompozohet përcjellja muzikore e cila në raste të rralla ka këndim apo fjalë të folura.

2.3. Opera është dramë në të cilën bashkëveprojnë kënga me përcjelljen orkestrale (si recitativet, ariet dhe koralet) si dhe pjesët instrumentale (si uvertyrat, preludet dhe interludet). Kjo formë është mjaft komplekse me vetë faktin se involvon disa drejtime artistiko-muzikore (instrumentale dhe vokale), dramën, poezinë, aktrimin, vallëzimin, skenografinë, kostumografinë etj. Përpos orkestrit, korit, baletit dhe solistëve vokal, shfaqja e operës domosdoshmërisht kërkon objektin adekuat, kurse rrallë herë mund të prezantohet në formën koncertale.

2.4. Këshilli koordinues konsultativ është organ këshillëdhënës i përbërë nga të tre drejtorët e institucioneve, një përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe një përfaqësues nga Fakulteti i Arteve. Ky organ nxjerr vendime në bazë të konsensusit.

Neni 3

Veçantia dhe rëndësia institucionale

3.1. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës ushtrojnë aktivitete dhe veprimtari kulturo- artistike me interes të veçantë për Kosovën.

3.2. Me këtë ligj mund të themelohen dhe të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe institucionet tjera të Filarmonisë, Operës dhe Baletit.

Neni 4

Themelimi dhe veprimtaria e Filarmonisë, Operës dhe Baletit

4.1. Institucionin e Filarmonisë, Operës dhe të Baletit në mbështetje të kushteve, kritereve dhe procedurave të caktuara me ligj mund t'i themelojnë:

- Personat juridikë;
- Personat fizikë dhe
- Personat juridikë e fizikë.

4.2. Themeluesit nga paragrafi paraprak i këtij neni mund të jenë vendorë dhe të jashtëm.

4.3. Themeluesit e jashtëm mund t'i themelojnë institucionet sipas paragrafit paraprak të këtij neni në bazë të parimit të reciprocitetit po qe se kjo është paraparë me marrëveshje bilaterale ose me lejen e Qeverisë së Kosovës.

Neni 5

Karakteri dhe natyra institucionale

5.1. Institucionet e Filarmonisë, Operës dhe Baletit themelohen dhe veprojnë si:

- Institucione publike dhe
- Institucione private.

5.2. Kuvendi i Kosovës themelon filarmoninë, operën dhe baletin si institucione publike të Kosovës.

Neni 6

Veprimtaria

6.1. Veprimtaria e Operës dhe e Baletit ushtrohet në mënyrë publike dhe trajtohet shërbim publik.

6.2. Veprimtaria e filarmonisë, operës dhe e baletit përfshinë:

- përgatitjen;
- organizimin dhe
- shfaqjen publike të operave, të baletit, të koncerteve dhe të formave të tjera skeniko - muzikore.

Neni 7

Selia dhe simbolet

7.1. Selia e Filarmonisë, Operës dhe e Baletit të Kosovës është në Prishtinë.

7.2. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës secila veç e veç i kanë simbolet e tyre identifikuese institucionale dhe artistike (stemat, distinktivët etj.).

7.3. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës kanë edhe vultat e mëvetësishme.

Neni 8

Mëvetësia

8.1. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës janë tri institucione të mëvetësishme skenike-muzikore të Kosovës.

8.2. Filarmonia, Opera dhe Baleti janë persona juridikë dhe si institucione të kulturës regjistrohen e licencohen në mënyrë vetanake nga autoriteti përkatës i Ministrisë së Kulturës.

8.3. Mënyrën, kushtet dhe kriteret e regjistrimit, mbajtjes së evidencës dhe akreditimit i rregullon me akt të veçantë nënligjor Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

8.4. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës hartojnë dhe i propozojnë secila në mënyrë të pavarur planet dhe programet vjetore të punës e të veprimtarisë, por bashkërisht e me konsensus i analizojnë, i miratojnë dhe i realizojnë ato.

8.5. Filarmonia, Opera dhe Baleti, ndonëse si institucione të pavarura, mund ta ushtrijnë punën, aktivitetin dhe veprimtarinë e tyre në të njëjtën ndërtesë.

8.6. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës, në të mirë të avancimit të punës e të aktiviteteve sa më të frytshme dhe arritjes së sukseseve optimale, janë të obliguara që në kushte të barabarta të bashkëpunojnë intensivisht dhe në vazhdimësi për realizimin e programeve dhe shfaqjeve të tyre me interes të përbashkët për to dhe për publikun.

Neni 9

Mjetet për sigurimin e punës dhe të veprimtarisë

9.1. Mjetet financiare për zhvillim normal, efikas dhe të suksesshëm për punë, aktivitete dhe veprimtari të Filarmonisë, Operës dhe Baletit i siguron themeluesi në përputhje me ligjin dhe në bazë të programeve e planeve financiare (sipas specifikave të veprimtarisë) dhe projekteve paraprakisht të miratuara.

9.2. Sipas këtij ligji themeluesi është i obliguar që Filarmonisë, Operës dhe Baletit t'ua sigurojë kushtet optimale për punë. Puna, aktivitetet dhe veprimtaria e Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës financohet nga Buxheti i Kosovës me zë të veçantë.

9.3. Institucionet e Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës mund ta zgjerojnë bazën e tyre materiale-financiare edhe nga burime të tjera të hyrash.

9.4. Me qëllim të realizimit të koordinimit, bashkëpunimit dhe bashkëveprimit profesional-artistik, Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës formojnë një trup të përbashkët koordinues dhe konsultativ. Qëndrimet dhe mendimet e këtij trupi nuk janë obliguese për zbatim nga ana e institucioneve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit.

9.5. Këshillin e përbashkët e përbëjnë drejtorët e institucioneve, një përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe një përfaqësues nga Fakulteti i Arteve-Dega e Muzikës.

9.6. Mënyra, kushtet dhe kriteret e punës së Këshillit të përbashkët, rregullohen me akt të veçantë nënligjor të cilin e bie Këshilli dhe e miraton Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 10

Kujdesi për veprimtarinë, institucionin dhe dokumentacionin

10.1. Institucionet e Filarmonisë, Operës dhe Baletit janë përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit, mjeteve të punës dhe rekuizitave.

10.2. Dokumentacioni me vlerë i Filarmonisë, Operës dhe i Baletit të Kosovës ruhet në vende, orendi dhe stabilimente përkatëse, në përputhje të plotë me ligjin mbi ruajtjen e materialit arkivor dhe standardeve më të avancuara ndërkombëtare në këtë lëmë.

Neni 11

Ndërprerja e punës dhe shuarja e veprimtarisë

11.1. Puna dhe veprimtaria e Operës dhe e Baletit ndërpritet, përkatësisht shuhet në përputhje me ligjin.

11.2. Vendimin përfundimtar për ndërprerjen e punës dhe të veprimtarisë së Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës si institucione kosovare e miraton Kuvendi i Kosovës, në propozim të Ministrisë së Kulturës.

11.3. Vendimin sikur në paragrafin paraprak për trupat tjera publike të Operës dhe të Baletit e bie themeluesi, pas propozimit të Ministrisë së Kulturës.

11.4. Vendimin për ndërprerjen, përkatësisht shuarjen e veprimtarisë së trupave private të Filarmonisë, Operës dhe Baletit dhe e bie themeluesi apo gjykata kompetente.

II. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE FUNKSIONIMI

Neni 12

Seksionet

12.1. Filarmonia e Kosovës, në tekstin e mëtejme Filarmonia, ka seksionin e orkestrës simfonike.

12.2. Institucioni i Operës i Kosovës, në tekstin e mëtejme Opera, ka këto seksione:

- Seksionin e orkestrës;
- Seksionin e korit të Operës dhe
- Seksionin e solistëve vokalë.

12.3. Institucioni i Baletit i Kosovës, në tekstin e mëtejme Baleti, ka këto seksione:

- Trupën e Baletit (të themeluar me 1972 në Teatrin e Kosovës);
- Solistët e Baletit.

12.4. Sipas nevojës dhe planeve zhvillimore, struktura dhe numri i seksioneve të të tri institucioneve mund të modifikohet.

12.5. Puna, organizimi dhe funksionimi i seksioneve të institucioneve të Operës, Baletit dhe Filarmonisë rregullohet më hollësisht me aktet të mëvetësishme të brendshme të tyre.

Neni 13

Organet udhëheqëse të Filarmonisë, Operës dhe Baletit

Organet kolegjiale dhe individuale udhëheqëse të Filarmonisë, Operës dhe Baletit janë:

- Këshilli drejtues;
- Drejtori;
- Këshilli artistik;
- Udhëheqësi artistik.

III. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 14

Qëllimet e Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës

Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës nxit, zhvillon, avancon, publikon dhe promovon krijimtarinë artistike kosovare dhe botërore nëpërmjet shfaqjeve dhe koncerteve, si dhe nëpërmjet:

- i). pjesëmarrjes në formimin e politikës strategjike dhe veprimtarisë - krijimtarisë artistike;
- ii). vlerësimin të gjendjes ekzistuese dhe propozimit të masave për avancimin e mendimit dhe ngritjen e cilësisë së krijimtarisë artistike skenike dhe muzikore;
- iii). shqyrtimit të problematikës së përgjithshme nga fushat e veprimtarisë krijimtarisë artistike skenike dhe muzikore;
- iv). organizimit të punës kërkimore-shkencore me karakter teorik e praktik në fusha të ndryshme të dijes së arteve përmes tubimeve, tryezave, këshillimeve, simpoziumeve, koncerteve, shfaqjeve dhe formave përkatëse të shprehjes së krijimtarisë artistike, skenike dhe muzikore etj.

- v). botimit të publikimeve të veta të rregullta dhe periodike nga fusha e artit skenik dhe muzikor;
- vi). bashkëpunimit brenda vendor dhe ndërkombëtar me institucionet përkatëse nga fusha e artit skenik-muzikor;
- vii). krijimit të kushteve, nivelit për depërtimin e mendimit dhe afirmimit të krijimtarisë artistike jashtë vendit;
- viii). përmirësimit të vazhdueshëm dhe avancimit të kushteve të punës së punëtorëve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës.
- ix). ndërmarrjes së veprimeve të tjera të interesit të veçantë për artin, për Kosovën dhe për popullatën e saj, e në mbështetje të së drejtës dhe të detyrimit të Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës për të qenë institucione sugjeruese, këshilluese, nxitëse dhe promovuese të artit skenik dhe muzikor në Kosovë në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit,
- x) përgatitjes dhe realizimit të koncerteve dhe shfaqjeve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit;
- xi) përgatitjes dhe kryerjes së punëve rreth pajisjes përkitazi me realizimin e projekteve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit;
- xii) regjistrimit dhe ruajtjes së incizimeve audio dhe vizuele për nevoja të veta si dhe për nevoja të medimeve të shkruara, elektronike dhe të interesuarve të tjerë;
- xiii) botimit të publikimeve, siç janë: librat, audiot dhe videoregjistrimet e Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës;
- xiv) sigurimit të hapësirës skenike dhe koncertale, të kostumeve, të dekorit, të pajisjeve teatrore, teknike si dhe transportit të pajisjeve të shfaqjeve dhe të pjesëmarrësve;

- xv) sigurimit të materialit të nevojshëm notar, të hapësirës së nevojshme koncertale dhe materialeve të tjera të nevojshme.

Neni 15

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë institucionale

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës dalin nga qëllimet e përgjithshme të tyre dhe ato përfshijnë sidomos:

- a). Pjesëmarrjen në planifikimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta me institucionet tjera kulturore për studimin dhe zhvillimin e artit, kulturës muzikore dhe aktivitetin skeniko muzikor;
- b). Planifikimin dhe zhvillimin intensiv e të vazhdueshëm të punës kërkimore-artistike në kuadër të veprimtarisë së vet;
- c). Hulumtimin, ngritjen, aftësimin, angazhimin dhe avancimin e kuadrit profesional përkatës në pajtim me standardet më të larta të krijimtarisë artistike;
- d). Pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta me institucionet e ngjashme të hapësirës shqiptare e ndërkombëtare me qëllim të ruajtjes, mbrojtjes dhe zhvillimit të vlerave të trashëgimisë kosovare dhe kulturës muzikore;
- e). Ruajtjen, kultivimin dhe prezantimin e traditave kulturore të qytetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit.

IV. VEÇANTITË ORGANIZATIVE DHE MENAXHUESE TË FILARMONISË, OPERËS DHE BALETIT TË KOSOVËS

Neni 16

16.1. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës janë bartëse të të drejtave, detyrave dhe përgjegjësive organizative dhe menaxhuese për fushat artistike për të cilat janë themeluar.

16.2. Në institucionet e Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës punojnë dhe veprojnë punëtorët e rregullt dhe bashkëpunëtorët e angazhuar të jashtëm të fushave përkatëse artistike.

16.3. Anëtari i rregullt i Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës mund të krijojë marrëdhënie të rregullt pune vetëm me njërën nga institucionet e parapara me këtë ligj, përkatësisht vetëm në njërin nga seksionet brenda institucionit.

16.4. Çdo anëtar i rregullt i Filarmonisë, Operës dhe i Baletit parimisht mund të angazhohet në punë dhe në detyra tjera sipas nevojës së institucioneve.

16.5. Punën e Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës, si dhe të seksioneve të tyre e udhëheqin organet përkatëse drejtuese dhe artistike të tyre.

16.6. Organizimi dhe puna e seksioneve dhe e njësive të Filarmonisë, Operës dhe të Baletit të Kosovës rregullohen më detajisht me statute dhe akte të tjera të veçanta nënligjore të secilit institucion veç e veç.

1. ORGANET UDHËHEQËSE TË FILARMONISË

1. Drejtori i Filarmonisë

Neni 17

Drejtori i Filarmonisë së Kosovës është udhëheqës dhe organ ekzekutiv i saj.

Neni 18

Autorizimet, detyrat dhe përgjegjësitë

Në cilësi të udhëheqësit të Filarmonisë drejtori i saj kryen dhe udhëheq këto punë:

1. Udhëheq punën e Filarmonisë;
2. E përfaqëson dhe përgjigjet për veprimtarinë materiale-financiare dhe për ligjshmëri e afarizëm të Filarmonisë;
3. Miraton programin vjetor të punës me pëlqimin paraprak të Këshillit drejtues;
4. Zbaton vendimet e Këshillit drejtues;
5. Propozon dhe nxjerr aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe aktin për shpërndarjen e pagave të cilin e miraton këshilli drejtues;
6. Merr vendim lidhur me marrëdhënien e punës së punëtorëve në pajtim me ligjin;
7. Në rast të moszgjidhjes së udhëheqësit artistik, me propozim të Këshillit artistik mund të emërojë ushtruesin e detyrës së udhëheqësit artistik në afat deri në 6 muaj;
8. Mbikëqyr punën dhe aktivitetet artistike të trupave artistike dhe këshillëdhënëse (të përhershme dhe të përkohshme) në pajtim me ligjin;

9. Kryen edhe punë të tjera lidhur me punën e Filarmonisë në pajtim me këtë ligj dhe me akte të tjera nënligjore;

10. Ka të drejtë dhe detyrë të marrë pjesë në punën e Këshillit drejtues dhe të komisioneve e të trupave të tjerë të tij pa të drejtë vote.

Neni 19

19.1. Drejtori zgjidhet në bazë të konkursit publik të shpallur nga Këshilli drejtues me propozim të Këshillit artistik.

19.2. Për drejtor të Filarmonisë zgjidhet personi me përgatitje profesionale universitare në fushën e artit dhe të kulturës, si dhe me përvojë e aftësi udhëheqëse.

Neni 20

20.1. Drejtori i Filarmonisë zgjidhet me mandat dhe në kohëzgjatje prej tre (3) vjetësh.

20.2. Personi i njëjtë mund të rizgjidhet.

Neni 21

Drejtorin e Filarmonisë e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli drejtues sipas procedurës së caktuar me ligj.

2. Këshilli drejtues i Filarmonisë

Neni 22

Këshilli drejtues i Filarmonisë së Kosovës është organi më i lartë kolegjal i saj.

Neni 23

Përbërja dhe përfaqësimi i Këshillit

23.1. Këshilli drejtues i Filarmonisë përbëhet nga 4 anëtarë dhe kryetari.

23.2. Në punën e Këshillit delegohen për anëtarë:

- Një (1) anëtar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Një (1) anëtarë nga shoqëria civile;
- Një (1) anëtar nga Fakulteti i Arteve;
- Dy (2) anëtarë, punëtorë të rregullt në marrëdhënie pune nga radhët e institucionit të Filarmonisë së Kosovës.

23.3. Këshilli drejtues i filarmonisë së nivelit komunal përbëhet nga 5 anëtarë:

- Një (1) anëtar delegohet nga drejtoria e kulturës e komunës gjegjëse;
- Dy (2) anëtarë të tjerë delegohen nga shoqëria civile-krijues të shquar artistik të skenës muzikore.
- Dy (2) anëtarë nga radhët e punëtorëve të rregullt të filarmonisë të nivelit përkatës.

23.4. Drejtori i filarmonisë ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit drejtues, të jep sqarime dhe propozime përkatëse, por pa të drejtë vote.

Neni 24

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit

Këshilli drejtues i Filarmonisë ka për detyrë, përgjegjësi dhe kompetencë që të:

- a). Miratojë statutin e Filarmonisë;
- b). Nxjerrë dhe të miratojë rregulloren dhe aktet e ndryshme normative që rregullojnë marrëdhëniet e caktuara nga veprimtaria e Filarmonisë;
- c). Miratojë programin dhe planin e punës së Filarmonisë;
- d). Miratojë planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të Filarmonisë;
- e). Zgjedhë drejtorin e Filarmonisë;
- f) Zgjedhë punëtorët e rregullt dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të angazhuar;
- g). Verifikojë zgjedhjen e udhëheqësit artistik të Filarmonisë;
- h). Kryejë edhe detyra të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin e Filarmonisë së Kosovës.

Neni 25

25.1. Mbledhjet e Këshillit drejtues të Filarmonisë i konvokon dhe i drejton kryetari i Këshillit.

25.2. Këshilli drejtues i Filarmonisë mund të punojë dhe të vendosë nëse në mbledhjet e tij janë të pranishëm shumica e anëtarëve të Këshillit (50+1).

25.3. Mënyra e punës, kompetencat dhe autorizimet e Këshillit rregullohen më për së afërmi me aktin e veçantë juridik të Filarmonisë.

3. Këshilli artistik i Filarmonisë

Neni 26

Këshilli artistik i Filarmonisë është organ kolegjal profesional, këshillëdhënës dhe vendimmarrës i saj.

Neni 27

Përbërja dhe përfaqësimi

27.1. Këshilli artistik i Filarmonisë përbëhet nga nëntë (9) anëtarë.

27.2. Këshillin artistik të Filarmonisë e përbëjnë:

- Drejtori i përgjithshëm i Filarmonisë;
- Udhëheqësi artistik i Filarmonisë;
- Përgjegjësi i seksionit të orkestrës simfonike;
- Tre (3) punonjës të tjerë profesionalë – ekspertë të filarmonisë;
- Tre (3) anëtarë delegohen nga jashtë.

27.3. Anëtarët e Këshillit artistik nga radhët e punëtorëve të rregullt të Filarmonisë zgjidhën drejtpërdrejt me vota të hapura ose me të fshehta nga tubimi i punonjësve të Filarmonisë.

27.4. Anëtarët e jashtëm të Këshillit artistik të Filarmonisë zgjidhen dhe delegohen nga institucionet përkatëse të shoqërisë civile, në suaza të kriterëve dhe procedurës së paraparë me ligj dhe me akte të përgjithshme të institucionit apo asociacionit i cili me kërkesë të Filarmonisë e delegon anëtarin në Këshill artistik të Filarmonisë.

Neni 28

Bashkëpunimi dhe koordinimi

28.1. Këshilli artistik, për të mirën e institucionit, bashkëpunon dhe koordinon punët me Këshillin drejtues, drejtorin e përgjithshëm të Filarmonisë, me institucionet e tjera simotra në Kosovë dhe jashtë saj, si dhe me të gjithë punonjësit e Filarmonisë.

28.2. Këshilli artistik i Filarmonisë i zbaton vendimet e Këshilli drejtues dhe vendimet e tij.

Neni 29

Udhëheqësi artistik i Filarmonisë

29.1. Udhëheqësi artistik i filarmonisë, është person përgjegjës profesional i filarmonisë.

29.2. Me propozim të drejtorit të Filarmonisë udhëheqësin artistik e zgjedh Këshilli artistik i Filarmonisë, ndërsa e verifikon Këshilli drejtues i saj.

29.3. Udhëheqësi artistik i Filarmonisë i përgjigjet për punën e tij drejtpërsëdrejti në shkallë të parë drejtorit të Filarmonisë, ndërsa në shkallë të dytë Këshillit artistik dhe Këshillit drejtues të saj.

Neni 30

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e organeve të Filarmonisë si dhe të udhëheqësit artistik të saj rregullohen më hollësisht me aktin e themelimit, me statutin dhe me aktet tjera të përgjithshme të Filarmonisë.

2. ORGANET UDHËHEQËSE TË OPERËS

1. Drejtori i Operës

Neni 31

Drejtori i Operës së Kosovës është udhëheqës i operës dhe organ ekzekutiv i saj.

Neni 32

Autorizimet, detyrat dhe përgjegjësitë

Drejtori kryen dhe udhëheq këto punë:

1. Udhëheq punën e Operës;
2. E përfaqëson dhe përgjigjet për veprimtarinë materiale-financiare dhe për ligjshmëri e afarizëm të Operës;
3. Miraton programin vjetor të punës me pëlqim paraprak të Këshillit drejtues;
4. Zbaton vendimet e Këshillit drejtues;
5. Propozon dhe nxjerr aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe aktin për shpërndarjen e pagave të cilin e miraton Këshilli drejtues;

6. Merr vendim lidhur me marrëdhënien e punës së punëtorëve në pajtim me ligjin;
7. Në rast të mos zgjedhjes së udhëheqësit artistik, me propozim të Këshillit artistik emëron ushtruesin e detyrës së udhëheqësit artistik në afat deri në 6 muaj;
8. Mbikëqyr punën dhe aktivitetet artistike të trupave artistike dhe këshillëdhënëse (të përhershme dhe të përkohshme) në pajtim me ligjin;
9. Kryen edhe punë të tjera në lidhje me punën e Operës në pajtim me këtë ligj dhe me akte të tjera nënligjore;
10. Ka të drejtë dhe detyrë të marrë pjesë në punën e Këshillit drejtues dhe të komisioneve e trupave të tjera të tij pa të drejtë vote.

Neni 33

33.1. Drejtori zgjidhet në bazë të konkursit publik të shpallur nga Këshillit drejtues me propozim të Këshillit artistik.

33.2. Për drejtor të Operës zgjidhet personi me përgatitje profesionale universitare në fushën e artit dhe të kulturës, si dhe me përvojë dhe aftësi udhëheqëse.

Neni 34

34.1. Drejtori i Operës zgjidhet me mandat dhe kohëzgjatje prej tre vjetësh.

34.2. Personi i njëjtë mund të rizgjidhet.

Neni 35

Drejtorin e Operës e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli drejtues sipas procedurës së caktuar me ligj.

2. Këshilli drejtues i Operës

Neni 36

Këshilli drejtues i Operës së Kosovës është organi më i lartë kolegjal i Operës.

Neni 37

Përbërja dhe përfaqësimi i Këshillit

37.1. Këshilli drejtues i Operës përbëhet nga 5 anëtarë.

37.2. Në punën e Këshillit delegohen për anëtarë:

- Një (1) anëtar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Një (1) anëtar nga shoqëria civile;
- Një (1) anëtar nga Fakulteti i Arteve;
- Dy (2) anëtarë, punëtorë të rregullt në marrëdhënie pune nga radhët e institucionit të Operës së Kosovës.

37.3. Këshilli drejtues i operës së nivelit komunal dhe privat përbëhet nga 5 anëtarë:

- Një (1) anëtar delegohet nga drejtorja e kulturës e komunës gjegjëse;
- Dy (2) anëtarë të tjerë të shquar artistik skenik-muzikor nga shoqëria civile-krijues;
- Dy (2) anëtarë nga radhët e punëtorëve të rregullt të operës së nivelit përkatës.

37.4. Drejtori i operës merr pjesë në mbledhjet e këshillit drejtues, jap sqarime dhe propozime, por pa të drejtë vote.

Neni 38

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit

Këshilli drejtues i Operës ka detyrë, përgjegjësi dhe kompetencë që të:

- a). miratojë Statutin e Operës;
- b). nxjerr dhe të miratojë rregulloret dhe aktet e ndryshme normative që rregullojnë marrëdhënie të caktuara nga veprimtaria e Operës;
- c). miratojë programin e punës së Operës;
- d). miratojë planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të Operës;
- e). zgjedhë drejtorin e Operës;
- f) zgjedhë punëtorët e rregullt dhe bashkëpunëtorët e angazhuar nga jashtë;
- g). në bazë të konkursit publik bie vendim për zgjedhjen e udhëheqësit artistik të ansamblit sipas propozimit të Këshillit artistik;
- h). kryejë edhe detyra të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin e Operës së Kosovës.

Neni 39

39.1. Mbledhjet e Këshillit drejtues të Operës i konvokon dhe i drejton kryetari i Këshillit.

39.2. Këshilli drejtues i Operës mund të punojë dhe të vendosë nëse në mbledhjet e tij janë të pranishme shumica e anëtarëve (50+1).

39.3. Mënyra e punës, kompetencat dhe autorizimet e Këshillit rregullohen më për së afërmi me aktin nënligjor përkatës.

3. Këshilli artistik i Operës

Neni 40

40.1. Këshilli artistik i Operës është organ kolegjal profesional, këshillëdhënës dhe vendimmarrës i saj.

40.2. Këshillin artistik të Operës e përbëjnë:

- Drejtori;
- Udhëheqësi artistik;
- Tre (3) punonjës të tjerë profesionalë (ekspertë) të Operës nga radhët e punëtorëve të rregullt dhe
- Një (1) nga jashtë.

Neni 41

Bashkëpunimi dhe koordinimi

41.1. Këshilli artistik bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë me Këshillin drejtues, me drejtorin e përgjithshëm, me institucionet tjera simotra në Kosovë dhe jashtë saj.

41.2. Këshilli artistik i zbaton vendimet e Këshilli drejtues dhe vendimet e tij.

Neni 42

Udhëheqësi artistik i Operës

42.1. Udhëheqësi artistik i Operës është person përgjegjës profesional i Operës.

42.2. Me propozim të drejtorit të Operës, udhëheqësin artistik e zgjedh Këshilli artistik i Operës, ndërsa e verifikon Këshilli drejtues i saj.

42.3. Udhëheqësi artistik i Operës është person me përgatitje profesionale universitare në fushën e artit, kulturës dhe zgjidhet në bazë të konkursit publik.

42.4. Udhëheqësi artistik i Operës për punën e tij i përgjigjet drejtorit të Operës, Këshillit artistik dhe Këshillit drejtues të saj.

Neni 43

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e organeve të Operës si dhe të udhëheqësit artistik të saj rregullohen me aktin e themelimit, me statutin dhe me akte të tjera nënligjore.

3. ORGANET UDHËHEQËSE TË BALETIT

1. Drejtori i Baletit

Neni 44

Drejtori i Baletit të Kosovës është udhëheqës i baletit dhe organ ekzekutiv i tij.

Neni 45

Autorizimet, detyrat dhe përgjegjësitë

Drejtori i Baletit kryen dhe udhëheq këto punë:

1. Udhëheq punën e Baletit;
2. E përfaqëson dhe përgjigjet për veprimtarinë materiale-financiare dhe për ligjshmëri e afarizëm të Baletit;
3. Miraton programin vjetor të punës, me pëlqim paraprak të Këshillit drejtues;
4. Zbaton vendimet e Këshillit drejtues;
5. Propozon dhe nxjerr aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe aktin për shpërndarjen e pagave, të cilin e miraton Këshilli drejtues;
6. Merr vendim lidhur me marrëdhënien e punës së punëtorëve në pajtim me ligjin;

7. Në rast të mos zgjedhjes së udhëheqësit artistik, me propozim të Këshillit artistik mund të emërojnë ushtruesin e detyrës së udhëheqësit artistik në afat deri në 6 muaj;
8. Mbikëqyr punën dhe aktivitetet artistike të trupave artistike dhe këshillëdhënëse (të përhershme dhe të përkohshme) në pajtim me ligjin;
9. Kryen edhe punë të tjera në lidhje me punën e Baletit në pajtim me këtë ligj dhe me akte të tjera nënligjore;
10. Ka të drejtë dhe detyrë të marrë pjesë në punën e Këshillit drejtues dhe të komisioneve e trupave të tjerë të tij pa të drejtë vote.

Neni 46

46.1. Drejtori zgjidhet në bazë të konkursit publik të shpallur nga Këshilli drejtues me propozim të Këshillit artistik.

46.2. Për drejtor të Baletit zgjidhet personi me përgatitje profesionale në fushën e artit dhe të kulturës, si dhe me përvojë dhe aftësi udhëheqëse.

Neni 47

47.1. Drejtori i Baletit zgjidhet me mandat dhe në kohëzgjatje prej 3 vjetësh.

47.2. Personi i njëjtë mund të rizgjidhet.

Neni 48

Drejtorin e Baletit e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli drejtues sipas procedurës së caktuar me ligj.

2. Këshilli drejtues i Baletit

Neni 49

Këshilli drejtues i Baletit të Kosovës është organi më i lartë kolegjal i Baletit.

Neni 50

Përbërja dhe përfaqësimi

50.1. Këshilli drejtues i Baletit përbëhet nga katër (4) anëtarë dhe kryetari.

50.2. Në punën e Këshillit delegohen për anëtarë:

- Një (1) anëtar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Një (1) anëtar nga shoqëria civile;
- Një (1) anëtar nga Fakulteti i Arteve;
- Dy (2) anëtarë, punëtorë të rregullt në marrëdhënie pune nga radhët e institucionit të Baletit të Kosovës.

50.3. Këshilli drejtues i baletit të nivelit komunal përbehet nga 5 anëtarë:

- Një (1) anëtar delegohet nga drejtoria e kulturës e komunës gjegjëse;
- Dy (2) anëtarë të tjerë delegohen nga shoqëria civile - krijues të shquar artistik skenik-muzikor;

- Dy (2) anëtarë nga radhët e punëtorëve të rregullt të baletit të nivelit përkatës.

50.4. Drejtori i baletit ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit drejtues, të jep sqarime dhe propozime, por pa të drejtë vote.

Neni 51

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit

Këshilli drejtues i Baletit ka për detyrë, përgjegjësi dhe kompetencë që të:

- a). Miratojë statutin e Baletit;
- b). Nxjerrë dhe miratojë rregulloren dhe aktet e ndryshme normative që rregullojnë marrëdhëniet e caktuara nga veprimtaria e Baletit;
- c). Miratojë programin e punës së Baletit;
- d). Miratojë Planin Financiar dhe Llogarinë Përfundimtare të Baletit;
- e). Zgjedhë drejtorin e Baletit;
- f). Zgjedhë punëtorët e rregullt dhe bashkëpunëtorët e angazhuar nga jashtë;
- g). Në bazë të konkursit publik bie vendim për zgjedhjen e udhëheqësit artistik të ansamblit sipas propozimit të Këshillit artistik.
- h). Kryejë edhe detyra të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin e Baletit të Kosovës.

Neni 52

52.1. Mbledhjet e Këshillit drejtues të Baletit i konvokon dhe i drejton kryetari i Këshillit.

52.2. Këshilli drejtues i Baletit mund të punojë dhe të vendosë nëse në mbledhjet e tij janë të pranishëm shumica e anëtarëve (50+1).

52.3. Mënyra e punës, kompetencat dhe autorizimet e Këshillit rregullohen më për së afërmi me aktin e veçantë juridik.

3. Këshilli artistik i Baletit

Neni 53

Këshilli artistik është organ kolegjal profesional, këshillëdhënës dhe vendimmarrës i Baletit.

Neni 54

Përbërja e Këshillit artistik të Baletit

54.1. Këshilli artistik i Baletit ka 9 anëtarë dhe ata janë:

- Drejtori i përgjithshëm i Baletit;
- Udhëheqësi artistik;
- Dy (2) përgjegjës të seksioneve;
- Tre (3) punëtorë profesionalë të zgjedhur nga tubimi dhe
- Dy (2) anëtarë të tjerë të deleguar nga jashtë.

54.2. Anëtarët e rregullt të Këshillit artistik të Baletit zgjidhen drejtpërsëdrejti me votë të hapur ose me votë të fshehtë nga tubimi i punonjësve të Baletit.

54.3. Anëtarët e jashtëm të Këshillit artistik të Baletit, delegohen nga institucionet përkatëse, përkatësisht nga shoqëria civile, në suaza të kriterëve dhe procedurës së përcaktuar me ligj dhe me akte të përgjithshme të institucionit apo të strukturës e cila e delegon anëtarin në Këshill artistik të Baletit.

Neni 55

Bashkëpunimi dhe koordinimi

55.1. Këshilli artistik i Baletit, bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë me Këshillin drejtues, me drejtorin e përgjithshëm, me institucionet tjera simotra në Kosovë dhe jashtë saj.

55.2. Këshilli artistik i Baletit i zbaton vendimet e Këshilli drejtues dhe vendimet e tij.

Neni 56

Udhëheqësi artistik i Baletit

56.1. Udhëheqësi artistik i Baletit është person përgjegjës profesional i Baletit.

56.2. Me propozim të drejtorit të Baletit, udhëheqësin artistik e zgjedh Këshilli artistik i Baletit, ndërsa e verifikon Këshilli drejtues i tij .

56.3. Udhëheqësi artistik i Baletit i përgjigjet për punën e tij drejtpërsëdrejti, në shkallë të parë, drejtorit të Baletit, ndërsa në shkallë të dytë Këshillit artistik dhe Këshillit drejtues të tij.

Neni 57

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e organeve të Baletit si dhe të udhëheqësit artistik të tij rregullohen më hollësisht me aktin e themelimit, me statutin dhe me akte të tjera të përgjithshme të Baletit.

Neni 58

Monitorimi dhe mbikëqyrja e punës së institucioneve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit

Monitorimin e rregullt dhe mbikëqyrjen e punës dhe të zbatimit të ligjshmërisë në institucionet kosovare të Filarmonisë, Operës dhe Baletit e bën Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa për institucionet e tilla në nivel komunal mbikëqyrjen e bën drejtoria përkatëse e kulturës.

Neni 59

Mbikëqyrja dhe kontrolli financiar

Revizionin dhe mbikëqyrjen financiare të punës dhe të veprimtarisë së institucioneve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës e bën themeluesi dhe autoriteti ligjor i autorizuar të paktën një herë në vit.

V. PUNËTORËT E FILARMONISË, OPERËS DHE TË BALETIT

Neni 60

60.1. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës në radhët e tyre kanë punëtorë të rregullt, por sipas nevojës mund të angazhojnë edhe bashkëpunëtorë të jashtëm.

60.2. Punonjësit e Filarmonisë, Operës dhe Baletit janë artistë profesionist të skenës së operës dhe të shkathtësive të baletit e të filarmonisë, si dhe punonjës të tjerë teknikë të lëmenjve përkatës.

60.3 Punonjësit e Filarmonisë, Operës dhe Baletit zgjidhen me propozimin e komisionit vlerësues profesional, pas paraqitjes së kandidatëve në audicion.

60.4. Punëtorët e rregullt janë të obliguar që t'i nënshtrohen audicionit çdo dy vjet, kurse për bashkëpunëtorët e jashtëm, audicionet mbahen para angazhimit të tyre.

Neni 61

Punëtorë të rregullt dhe bashkëpunëtorë të jashtëm të Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës zgjidhen punonjësit profesionalë të artit që kanë të arritura të veçanta në lëmenjtë e tyre, të cilët në audicionet e rregullta tregojnë dhe dëshmojnë profesionalizëm artistik.

Neni 62

Për zgjedhjen dhe emërimin e punëtorëve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit zbatohen dispozitat e ligjit për shërbimin civil të Kosovës, të statuteve të tyre, si dhe të akteve të tjera nënligjore.

Neni 63

63.1. Marrëdhënia e punës me punëtorë të rregullt të Filarmonisë, Operës dhe Baletit themelohet me konkurs publik, rrjedhimisht me kontratë me shkrim, të bazuar në ligj.

63.2. Relacionet e bashkëpunimit, të shërbimeve dhe të pagesës së bashkëpunëtorëve të jashtëm të angazhuar rregullohen me kontratë, përkatësisht me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të caktuara, të bazuar në ligj dhe në aktet tjera nënligjore.

Neni 64

64.1. Punëtorëve të rregullt të angazhuar të Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës u takon paga e përhershme mujore, ndërsa bashkëpunëtorëve të jashtëm u takon shpagimi për punën apo shërbimin e kryer.

64.2. Kushtet dhe kriteret e kompensimit të kohës së kaluar dhe kontributit të dhënë në mbledhjet e këshillave drejtuese dhe artistike të anëtarëve të jashtëm të Filarmonisë, Operës dhe Baletit caktohen dhe zbatohen në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore të bazuara në ligj.

Neni 65

Vlerësimi për të arritura të veçanta dhe kulmore

65.1. Punëtorët e institucionit të Filarmonisë, Operës dhe Baletit për punën e tyre të spikatur, cilësore, të talentuar dhe shumëvjeçare mund të avancohen, falënderohen dhe shpërblehen.

65.2. Çmimet, mirënjohjet, shpërblimet dhe titujt e merituar profesionalë për të arritura të veçanta në nivel të institucionit, të degës dhe në nivel nacional për të arriturat në këto sfera të kulturës ndahen nga ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me propozim të komisionit të veçantë të ekspertëve kompetentë të Ministrisë si vlerësues për të arriturat në të gjitha fushat e kulturës në Kosovë.

Neni 66

Kushtet dhe kriteret preferenciale

66.1. Për arsye të specifikave profesionale, punëtorëve profesionalë të Filarmonisë frymorët, Operës solistët vokal, dhe të Baletit solistët e baletit u takon e drejta në pension të mëhershëm - me kohëzgjatje të shtuar.

66.2. E drejta në pension të mëhershëm - të veçantë iu takon punëtorëve nga paragrafi paraprak i këtij neni, pas kalimit të vazhdueshëm, efikas dhe efektiv në aktivitete skenike të periudhës kohore prej 18 - 25 vjet dhe nëse në ndërkohë është shfaqur invaliditeti i shkallës së parë.

66.3. Kushtet, kriteret dhe procedurat përkitazi me çështjet nga paragrafi një dhe dy të këtij neni i rregullon Qeveria me aktin e veçantë juridik.

VI. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE-ARTISTIKE E TEKNIKE

Neni 67

67.1. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës i kanë shërbimet e tyre të mëvetësishme administrative, profesionale dhe teknike.

67.2. Institucionet nga paragrafi paraprak i këtij neni mund të organizojnë një shërbim të vetëm të përbashkët administrativ dhe të përgjithshëm profesional, artistik dhe teknik.

67.3. Secila nga të tri institucionet e veçanta ose të përbashkëta mund t'i kenë sektorët, seksionet apo njësitë përkatëse brenda shërbimit teknik-administrativ, profesional dhe artistik.

67.4. Njësitë e institucioneve nga paragrafi i parë i këtij neni, me leje të qendrës - selisë, mund t'u besohen kryerja e punëve, aktiviteteve dhe funksioneve të caktuara udhëheqëse dhe mund të kenë këshill dhe udhëheqës të njësisë.

VII. FINANCIMI I FILARMONISË, OPERËS, DHE I BALETIT

Neni 68

68.1. Mjetet e nevojshme themelore dhe financiare për punën, aktivitetet dhe veprimtarinë e Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës sigurohen nga Buxheti i Kosovës, në zëra të veçantë.

68.2. Me mjetet nga Buxheti i Kosovës financohet veprimtaria e Filarmonisë, Operës dhe e Baletit.

68.3. Financimi i projekteve të Filarmonisë, Operës dhe të Baletit të Kosovës bëhet në bazë të konkurseve të shpallura.

68.4. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës mund të sigurojnë mjete edhe nga donacionet e sponsorimet dhe ato mjete mund t'i përdorin për veprimtarinë plotësuese, përkatësisht për përmirësimin dhe zhvillimin e bazës materiale-financiare dhe të perspektivës së tyre më të mirë.

Neni 69

69.1. Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës, si dhe institucionet tjera private ose publike të Filarmonisë, Operës dhe Baletit janë pronarë të pasurisë të cilën e disponojnë ligjërisht.

69.2. Në rast të ndarjes, bashkimit ose të shuarjes së institucioneve nga paragrafi paraprak i këtij neni, bartja e mjeteve dhe e pasurisë bëhet sipas ligjeve në fuqi në Kosovë.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 70

Pëlqimin për aktet e përgjithshme normative të Filarmonisë, Operës dhe të Baletit e japin themeluesit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 71

Institucionet dhe organet e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor kanë ndaj Filarmonisë, Operës dhe të Baletit vetëm ato të drejta dhe obligime taksativisht të caktuara me ligj.

Neni 72

Pas aprovimit të këtij ligji Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës, si institucione ekzistuese, janë të obliguara që në afat prej 6 muajve t'i harmonizojnë të gjitha aktet përkatëse nënligjore me këtë ligj dhe t'u nënshtrohen kriterëve dhe procedurave akredituese. Institucionet tjera të operës dhe të baletit, varësisht nga interesimi, janë të obliguara sipas këtij ligji që të themelohen, të regjistrohen dhe të akreditohen për të pasur mundësi të ushtrojnë veprimtarinë e tyre skenike-muzikore dhe operistike-baletore.

Neni 73

73.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që në afat prej 90 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji t'i nxjerrë të gjitha aktet nënligjore të cilat duhet nxjerr sipas këtij ligji.

73.2. Deri në skadimin e afatit të paraparë në paragrafin paraprak të këtij neni, institucionet ekzistuese të Filarmonisë, Operës dhe të Baletit mund të veprojnë dhe të punojnë në bazë të atyre dispozitave të përparshme ligjore.

Neni 74

Organet ekzistuese kolegjiale dhe individuale udhëheqëse të Filarmonisë, Operës dhe të Baletit i kryejnë funksionet e veta deri në zgjedhjet dhe emërimet e organeve të reja në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 75

Ditën që hyn në fuqi ky ligj pushojnë së ekzistuari të gjitha dispozitat ligjore dhe nënligjore të cilat janë në kundërshtim me të.

Neni 76

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

12.08.2006

UNMIK/REG/ 2006/42